



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr. 61
Prishtinë, më 14 dhjetor 2023, në orën: 09:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Valon Ramadani, Mergim Lushtaku, Fidan Jilta, Tinka Kurti, Nijazi Isaku, Fitim Haziri, Besim Muzaqi, Isak Shabani dhe Agim Veliu.

Mungoi: Besnik Tahiri.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi Valon Ramadani, kryetar i komisionit, me këtë:

Rend të ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve të përhershme lidhur me Projektligjin nr. 08/L-244 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua me një pikë shtesë, miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve të përhershme lidhur me Projektligjin nr. 08/L-244 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare

Valon Ramadani, konfirmoi se Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, duke vepruar në pajtim me vendimin e Kuvendit nr. 08-V-638 i datës 02 nëntor 2023, në mbledhjet e mbajtura me 10.10, 21.11, 07.12, e shqyrtoi dhe amendamenti Projektligjin nr. 08/L-244 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, dhe të njëjtin e ka proceduar për shqyrtim sipas kompetencës në komisionet e përhershme.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, në mbledhjen e mbajtur me 07.12.2023, shqyrtoi Projektligjin dhe amendamentet e propozuara për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e e Ligjit nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare vlerësoi se projektligji dhe amendamentet janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

Komisioni për Integrim Evropian, në mbledhjen e mbajtur më 07.12.2023, shqyrtoi Projektligjin dhe amendamentet e propozuara për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e e Ligjit nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare dhe vlerësoi se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian..

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në mbledhjen e mbajtur me 13.12.2023, shqyrtoi Projektligjin dhe amendamentet e propozuara për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e e Ligjit nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare dhe vlerësoi se projektligji dhe amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në mbledhjen e mbajtur më 13.12.2023, shqyrtoi Projektligjin dhe amendamentet e propozuara për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare dhe vlerësoi se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit nr. 08-V-638 i datës 02 nëntor 2023 vendosi që për shqyrtimin e Projektligjit, Kuvendit ti paraqes raportin me amendamente. Raporti për Kuvend përmban gjithsejt 4 amendamente.

Konstatim: Komisioni, me 6 vota “Për” votoi Raportin me amendamente dhe vendosi që Kuvendit t’ia procedojë për shqyrtim të dytë në seancë plenare.

4. Të ndryshme.

Mergim Lushtaku, kërkoi, që të bëhet një vizitë në KPMSHCK, siç është kërkuar nga ai, në një të mbledhjet e kaluara.

Valon Ramadani, tha se në mbledhjen e kaluar, komisioni ka vendosur që këto vizita t'i realizojë në sesionin pranveror të vitit 2024, dhe pyeti anëtarët e komisionit, po qe se ka dikush propozime, diskutime apo kërkesa tjera.

Meqë nuk kishte kërkesa për diskutim, kryetari i komisionit mbylli mbledhjen për sesionin vjeshtor.

Mbledhja përfundoi në orën: 10:10.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Valon Ramadani

Kryetar i Komisionit